



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

# PLANI I INTEGRITETIT PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT RAJONAL (2024-2026)



Prishtinë, 2024

## PËRMBAJTJA

1. DEKLARATA PËR INTEGRITET .....	3
2. HYRJE .....	4
Për institucionin dhe planin e integritetit.....	4
3. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT .....	5
4. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT .....	6
5. METODOLOGJIA .....	7
6. PËRGJEGJËSITË BRENDA INSTITUCIONIT .....	8
7. PYETËSORI PËR RREZIKUN E MZHR NGA KORRUPSIONI DHE CENIMI I INTEGRITETIT .....	9
8. VETËVLERËSIMI DHE PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË RRREZIKUT NGA KORRUPSIONI DHE CENIMI I INTEGRITETIT.....	11
9. FUSHAT ME MUNDËSI RREZIKUT .....	12
10. MATRICA E VLERËSIMIT TË INTENSITETIT TË RREZIKUT .....	13
11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITET ....	14
12. MATRICA E IDENTIFIKIMIT TE RREZIQEVE.....	15



## 1. DEKLARATA PËR INTEGRITET

Deklarata e Integritetit ka për qëllim ofrimin e një deklaratë gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikën, procedurat dhe masat operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Procesin e integritetit për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, jemi munduar që t'i harmonizojmë aktivitetet me parimet dhe vlerat e proklamuar në dokumentet më të rëndësishme duke siguruar respektimin dhe bërjen e dukshme të tyre. MZHR, këtë plan e sheh si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm në sistemin e menaxhimit dhe fuqizimit të rezistencës së institucionit ndaj korrupsionit. Kjo, mund të arrihet përmes krijimit të mekanizmave duke përfshirë parandalimin, kontrollin, llogaridhënien dhe transparencën. Ne si MZHR, zotohemi që me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin që të bëjmë zhvillimin e kapacitetit të personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me planin e integritetit, si dhe të menaxhojmë në mënyrë adekuate të gjitha rreziqet të këtij plani me të cilin ne do të ballafaqohemi.

Ministria e Zhvillimit Rajonal, do të jetë e përkushtuar të implementoj të gjitha masat e planifikuara, por gjithsesi dhe të bëjë përpjekje për të integruar menaxhimin e riskut ndaj planit të integritetit në kulturën e institucionit në mënyrë të qëndrueshme. I gjithë institucioni duhet të jetë përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkelje tjetër të integritetit. Ne si institucion do i mbajmë zotimet tona karshi palëve të interesit, pa përjashtuar përgjegjësit të cilët veprojnë tek ne. Po ashtu ne me përkushtimin më të madh do të arrijmë që të fitojmë besimin duke vepruar me integritet dhe sjellje, ashtu siç është e paraparë dhe me kodin etik, përkatësisht bazuar në plan dhe legjislacionet në fuqi.

Për fund, një falënderim i madh shkon për të gjithë anëtarët e Grupit Punues për hartimin e planit të integritetit, të cilët kanë bërë që ky dokument të jetë i finalizuar dhe i cili do të na ndihmojë në fuqizimin e integritetit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Po ashtu, mbetet që në të ardhmen, zyrtarët dhe palët e interesit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, të japin kontributin e tyre maksimal që të implementojnë dokumentin në fjalë, i cili do të arritet vetëm duke forcuar bashkëpunimin e ndërsjellët dhe avancimin i cili tanimë se ekziston.

Me respekt,  
**Besim Kamberaj**

U.D. Sekretar i Përgjithshëm

## 2. HYRJE

Për institucionin dhe planin e integritetit

Në pajtim me legjislacionin në fuqi përkatësisht nenin 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit/APK, si dhe në përputhje me Metodologjinë për Planin e Integritetit, miratuar me Vendim të datës 26.07.2023 nga APK, të cilat obligojnë të gjitha institucionet shtetërore të hartojnë dhe miratojnë Planin e Integritetit, Ministria e Zhvillimit Rajonal bazuar në obligimet ligjore dhe duke u mbështetur në dokumentin e lartcekur ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave për zbatimin e Ligjit 08/L-190, Ministria e Zhvillimit Rajonal mbanë përgjegjësi për zhvillimin e politikave dhe programeve për zhvillim rajonal dhe të bashkëpunimit ndër rajonal për të reduktuar pabarazitë rajonale.

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që shërben si një instrument crucial për përmirësimin e integritetit institucional duke adresuar standardet më të larta profesionale, atyre të etikës dhe rregullave të zbatueshme normative. Ky dokument do të shërbej si dokument i brendshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për një periudhë tre (3) vjeçare, duke vendosur një kuadër gjithëpërfshirës të rregullave dhe udhëzimeve të dizajnuara për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit, specifikon masat për t'i parandaluar. Plani duhet shqyrtohet dhe përditësohet çdo vit, në mënyrë që të përputhet me ndryshimet normative, insticuionale dhe procedurale relevante.

Ky Plan është hartuar duke u bazuar në një proces të dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmerisë së integritetit brenda Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR-së), dhe ofron masa konkrete për menaxhimin e integritetit me qëllim për të arritur objektivat e integritetit të MZHR-së.

Në plan për integritet, shfaqet përkushtimi i MZHR-së për të fuqizuar kontrollet ekzistuese në të gjitha aktivitetet brenda detyrave dhe përgjegjësi që ka Ministria e Zhvillimit Rajonal. Kjo përfshinë veprime të caktuara për të rritur transparencën, për të zvogëluar rrezikun e konfliktit të interesit, dhe për të krijuar një mjedis llogaridhënës dhe të integruar brenda MZHR-së.



Plani i integriteti është i përbërë nga tri segmente :

Në pjesën e parë, specifikohet qëllimi dhe procesi i zhvillimit të planit. Kjo pjesë ofron një shpjegim të detajuar për arsyet dhe hapat e ndjekur gjatë hartimit të planit të integritetit.

Segmenti i dytë përfshin një listë të metodologjisë së përdorur për zhvillimin e planit. Ky segment përfshin metodat e përdorura për të kuptuar dhe adresuar çështjet e integritetit, përfshirë hulumtimin ligjor, përdorimin e pyetësorëve dhe të tjera.

Pjesën e tretë, pasqyron rezultatet dhe gjetjet e arritura përmes aplikimit të metodologjisë së përdorur. Ky segment ofron një analizë të thellë të dhënave dhe informacioneve të mbledhura duke u bazuar në hulumtimin dhe metodologjinë e përdorur.

### **3. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Përmes Planit të Integritetit, Ministria e Zhvillimit Rajonal synon të arrij:

1. Identifikimin e rreziqeve bazuar në fushat përkatëse që mund të çojnë në korrupsion dhe cenimin e integritetit;
2. Të përcaktojë dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për të zvogëluar rreziqet e identifikuar duke përfshirë masat preventive dhe korrigjuese.
3. Ngritja e besimit dhe përkushtimit ndaj integritetit mes stafit dhe palëve të interesit të jashtëm, për të siguruar ambient punues që përmbush standardet të larta të integritetit dhe transparencës.

Qëllimet e Planit të Integritetit janë:

1. Të krijojë një sistem efektiv për menaxhimin e integritetit brenda institucionit.
2. Të sigurohet informacioni dhe transparenca në të gjitha nivelet e veprimtarisë së institucionit, duke përfshirë informimin e palëve të interesuara dhe publikut për veprimtarinë dhe vendimet e marra në lidhje me integritet.
3. Të ndërtoj një rezistencë institucionale të fortë kundër çdo lloj cenimi të integritetit, duke promovuar vlerat dhe standarde të qarta të sjelljes etike dhe integritet profesional.
4. Planifikimin e menaxhimit të rrezikut të lidhur me integritetin në institucion, përmes të cilit synohet të identifikohen dhe të adresohen potencialet e rrezikut për integritetin në

mënyrë proaktive, duke vepruar për të parandaluar dhe lejuar menaxhimin e situatave të rrezikshme.

#### **4. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

Procesi i hartimit të planit të Integritetit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme.

Faza e parë: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ka marrë vendim për emërimin e Kryesuesit/Koordinatorit, Anëtarëve, si dhe emërimin e personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.

Gjatë kësaj faze, Grupi Punues ka zhvilluar takime dhe kanë konsoliduar të gjitha informacionet e nevojshme për të hartuar planin e Integritetit si dhe njoftimin e të gjithë stafit për rëndësinë dhe qëllimin e këtij plani.

Gjatë kësaj faze grupi punues i kushtoi një vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor, standardet dhe proceset e punës të këtij institucioni, gjithashtu u analizuan edhe raportet vjetore të punës, raportet e auditimit si dhe dokument tjera të nevojshme në të cilën u informuam për performancën e MZHR-së.

Faza e Dytë: Filluam me përgatitjen dhe miratimin e pyetësorit nga grupi punues. Me datë 03.04.2024 pyetësori u përgatitë dhe është shpërndarë për plotësim përmes platformës Google Forms te zyrtarët e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për të matur perceptimet e tyre mbi çështje të integritetit dhe etikës në institucion si edhe për të vlerësuar njohuritë e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural për integritetin në institucion.

Afati për plotësimin e pyetësorit ishte brenda shtatë ditëve në mënyrë që të shprehin mendimin e tyre individual lidhur me gjendjen dhe masat për mbrojtjen e integritetit.

Pyetësorin e plotësuan gjithsej 51.85% e stafit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Plotësimi i formularit ishte në mënyrë anonime. Janë zhvilluar takime me drejtorë dhe udhëheqësit e divizioneve, duke përfshirë përgjegjësit e procesit të fushës së identifikuar të rrezikut për të siguruar ndryshimet e nevojshme.

Faza e tretë: Grupi i punës vlerësoi nivelin e rrezikut të analizuar në fazën e mësipërme, pra identifikoi dhe analizoi faktorët e rrezikut që mund të kontribuojnë ose rrisin këto rreziqe.

Në këtë fazë të procesit kontribuan gjithashtu diskutimet dhe feedback-u i marrë nga fokus grupet me stafin e departamenteve të ndryshme të institucionit.

Grupi i punës hartoi planin e integritetit për menaxhimin e rrezikut të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2024-2026.

## 5. METODOLOGJIA

Metoda e hartimit të planit të integritetit :

Metoda analitike - me anë të së cilës janë analizuar të dhënat e ndryshme në institucionin me qëllim që të bëhet më e kuptueshme dhe të zbulohet më mirë struktura dhe natyra çështjes e cila është duke u trajtuar.

Metoda statistikore - përmes kësaj metode janë analizuar të dhënat të cilat janë si rezultat i pyetësorit i cili është dërguar tek zyrtarët e MZHR-së.

Mjetet për realizimi e planit të integriteti është pyetësori përmes të cilit janë mbledhur të dhënat dhe janë analizuar së bashku me dokumentet tjera të marrura nga institucioni.

Grupi punues në fillim ka analizuar me kujdes

1. Legjislacionin ne fuqi në të cilin dalin obligimet e MZHR-së, për ndërmarrjen e veprimeve për zhvillim rajonal të balancuar dhe bazën ligjore që krijojnë transparencë, llogaridhënie dhe rritje të besimit të publikut në institucion.
2. Dokumentet e brendshme të Ministrisë që përfshijnë, planet e punës, raportet e performancës, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës.



Për Hartimin e planit të Integriteti është dërguar pyetësori për plotësim të të gjithë zyrtarët e MZHR-së, nga i cili janë mbledhur mendimet dhe përvojat e zyrtarëve mbi nivelin, gjasat dhe fushat për ekspozim ndaj korrupsionit dhe shkeljes së integritetit e gjithashtu edhe masat të cilat sipas tyre duhet të ndërmerren në mënyrë që të parandalohen këto dukuri brenda Institucionit.

Në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal pyetësorin e kanë plotësuar 51.85% e stafit nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve aktual sa ishte në periudhën kur iu është dërguar pyetësori.

Grupi punues pasi ka mbledhur të gjitha të dhënat, ka filluar hartimin e planit të integritetit duke analizuar të gjitha të dhënat.

## 6. PËRGJEGJËSITË BREDA INSTITUCIONIT

Ministria e Zhvillimit Rajonal, mbanë përgjegjësi për zhvillimin e politikave dhe programeve për zhvillim rajonal dhe të bashkëpunimit ndër rajonal për të reduktuar pabarazitë rajonale.

Ministria kryen funksionet e saj me qëllim që të ofrojë zhvillim rajonal të balancuar me integritet dhe transparencë.

Bazuar në Ligjin nr.08/L-190 për Zhvillimin Rajonal të Balancuar , Rregullore (ZKM) nr. 02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë për Zhvillim Rajonal, për kryerjen e punëve dhe detyrave, është e organizuar në këto njësi organizative:

1. Zyra e Sekretarit të përgjithshëm;
2. Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
3. Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale
4. Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
5. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme
6. Divizioni për Buxhet dhe Financa;
7. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
8. Divizioni Ligjor;
9. Njësia e Auditimit të Brendshëm;
10. Divizioni për Komunikim Publik;
11. Divizioni i Prokurimit.



Në bazë të legjislacionit i cili mbulon këto fusha, Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka obligime dhe përgjegjësi të avancoj edhe mekanizmat kundër korrupsionit, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave, mbrojtjen e sinjalizuesve, parandalimin e konfliktit të interesit, informimit të publikut dhe ato të ruajtjes së integritetit.

## **7. PYETËSORI PËR RREZIKUN E MZHR NGA KORRUPSIONI DHE CENIMI I INTEGRITETIT**

Në kuadër të zhvillimit të Planit të Integritetit, Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ka krijuar pyetësin I cili është realizuar përmes platformës Google Forms, zyrtarët kanë ndarë mendimet dhe përvojat e tyre në lidhje me nivelet, probabilitetin dhe fushat e ekspozimit ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të integritetit.

Përveç kësaj, ata kanë sugjeruar masat që duhet të merren për të parandaluar këto fenomene brenda institucionit.

Pyetjeve në pyetësor i janë përgjigjur 14 zyrtarë, përkatësisht 51.85% nga numri total të cilëve ju është dërguar për plotësim.

Në pyetjen *“Sa mendoni se MZHR është e rrezikuar nga korrupsioni dhe cenimi i integritetit?”*

Nga zyrtarët të cilët janë përgjigjur, 7.1% e zyrtarëve mendojnë se MZHR-ja nuk rrezikohet aspak, 7.1% e zyrtarëve mendojnë ky rrezik është gjithmonë relevant duke llogaritur funksionin dhe aktivitetet që zhvillon, 21.4% mendojnë se MZHR rrezikohet shumë, 64.3% nuk kane ndonjë gjykim..

Në pyetjen *“Sa mendoni se janë gjasat që në MZHR të ndodhin raste të korrupsionit dhe cenimit të integritetit”* 57.1% e zyrtarëve mendojnë që gjasat janë të ulëta që raste të korrupsionit dhe cenimit të integritetit të ndodhin në MZHR, 21.4 mesatarisht dhe 21.4% i lartë.

Në pyetjen *“Çfarë lloj ndikimi mendoni se do të kishin këto raste në integritetin e MZHR ”*, 28.6% e zyrtarëve mendojnë se ndikimi do të ishte i lartë, 50% e zyrtarëve mendojnë se rastet do kishin ndikim mesatar, 14.3% të ulët dhe 7.1% nuk ka ndikim .

*“A jeni personalisht në dijeni për raste të korrupsionit dhe cenimit të integritetit në MZHR?”*, të gjithë zyrtarët kanë deklaruar se nuk janë në dijeni të këtyre rasteve.

*Në pyetjen “ Në çfarë fushe mendoni se mund të ketë më shumë rrezik për korrupsion dhe cenim të integritetit? ”*, 71.4 % e zyrtarëve kanë vlerësuar Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonale si fushë me më shumë rrezik, si fushë me rrezik mesatar Divizioni i Prokurimit, ndërsa për fushat tjera kanë dhënë mendim se rreziku për korrupsion është më i ulët.

Lidhur me lajmërimin dhe raportimin e korrupsionit 64.3%% e zyrtarëve kanë deklaruar se nuk kanë njohuri lidhur me ndonjë praktikë të lajmërimit dhe raportimit të korrupsionit në MZHR.

Te pyetja a mendojnë se *“A mendoni se mund të raportoni lirshëm ndonjë rast të korrupsionit apo shkelje të integritetit ne MZHR ”* 35.7% mendojnë se mund të raportojnë lirshëm, 28.6% thonë se nuk mund të gjykoj dhe 14.3% thonë ne disa raste, varësisht prej rrethanave, 14.3% mendojnë jo.

Megjithatë, në pyetjen *“A keni raportuar ndonjë rast të tillë”* 92.9% e zyrtarëve kanë theksuar se asnjëherë nuk kanë hasur në raste të tilla 7.1% mendojnë se nuk mund të gjykoj

Në pyetjen *“A keni ndjekur ndonjë trajnim mbi integritetin gjatë dy viteve të fundit?”* pothuajse të gjithë zyrtarët (100%) kanë mohuar të kenë ndjekur ndonjë trajnim.

Ndërsa sa i përket pyetjes *“A mendoni që keni nevojë për ndonjë trajnim të specializuar për integritetin që mund të ju ndihmojë për të performuar më mirë në punën tuaj?”*

71.4% e zyrtarëve mendojnë se kanë nevojë për trajnim të specializuar për integritetin, në mënyrë që të performojnë më mirë në punën e tyre, ndërsa tjerët kanë deklaruar se nuk kanë nevojë për një trajnim të tillë.

Pyetja lidhur me sigurinë e zyrtarëve për identifikimin e konfliktit të interesit janë të sigurtë janë deklaruar 57.1%, ndërsa 28.6% ka deklaruar që deri diku janë të sigurt, dhe 14.3% kanë deklaruar që mungon/nuk e di.

## **8. VETËVLERËSIMI DHE PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË RRREZIKUT NGA KORRUPSIONI DHE CENIMI I INTEGRITETIT**

Në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal numri i vogël i stafit ka sjellë vështirësi në përmbushjen e detyrave edhe përgjegjësive të institucionit, kjo situatë ka krijuar një ngarkesë të madhe për zyrtarët, duke çuar në zvogëlimin e efikasitetit dhe kontrollit më i vogël në punë.

Në MZHR ekziston perceptimi se rreziku i korrupsionit dhe cenimit të integritetit është i ulët. Në fakt, vitet e fundit nuk janë raportuar raste të korrupsionit apo cenimit të integritetit në Departamentet e MZHR-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga pyetësi ku zyrtarët nuk kanë qenë në dijeni personalisht për ndonjë rast të korrupsionit.

Po, një aspekt i rëndësishëm është që të gjithë zyrtarët të kenë besim se janë të lirë dhe të sigurt në raportimin e rasteve të korrupsionit dhe cenimit të integritetit, dhe që lajmëruesit janë të mbrojtur me ligj.

Megjithatë, një çështje që vazhdon të shqetësojë është mungesa e njohurive në lidhje me procedurat dhe praktikat për raportimin e korrupsionit. Prandaj, është shumë e rëndësishme të përqendrohemi në aftësimin për këto çështje, për të siguruar që edhe në raste kur ka dyshime për korrupsion dhe cenim të integritetit, ato raportohen në mënyrë të duhur dhe trajtohen nga MZHR dhe institucionet e relevante.

Gjithashtu, 71.4% e të anketuarve kanë theksuar që nuk kanë ndjekur trajnim për integritet andaj është e nevojshme aftësimi profesional lidhur me integritetin. Aftësimi mbetet i rëndësishëm në fushën e konfliktit të interesit, duke përqendruar vëmendjen në identifikimin dhe zvogëlimin e konfliktit të interesit, si dhe në promovimi i sinjalizimit .



## 9. FUSHAT ME MUNDËSI RREZIKUT

Ndryshimet ligjore, digjitalizimi i proceseve dhe masat e brendshme të kontrollit, kanë ndihmuar në parandalimin e korrupsionit dhe mbrojtjen e integritetit në shkallë të gjerë. Megjithatë, për shkak të vazhdueshëm të rrezikut, është e rëndësishme të vazhdohet me zbatimin progresiv të masave të ndryshme.

Në fushën e burimeve njerëzore, edhe pse gjasat për korrupsion ose cenim të integritetit janë ulur shumë me legjislacionin aktual me përdorimin e një sistemi të përgjithshëm për të gjitha proceset e punësimit, sektori përkatës duhet të sigurohet që sistemi të përdoret nga të gjithë zyrtarët dhe të përditësohet me të dhëna .

Gjithashtu, është e rëndësishme të harmonizohet dhe koordinohet pjesëmarrja në trajnime punëtori, udhëtime zyrtare dhe aktivitete të tjera të organizuara nga donatorët apo institucionet e tjera, kjo do të siguronte një pasqyrë të qartë të nevojave, kualifikimeve dhe pjesëmarrjes së stafit në aktivitetet e tilla.

Si fushë me mundësi rrezikut në MZHR konsiderohet, Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonale si fushë me më shumë rrezik ku kujdes të veçantë duhet kushtuar në rastet e procedurave të implementimit të projekteve sidomos në procesin e vlerësimit të projekteve, si fushë me rrezik mesatar konsiderohet Divizioni i Prokurimit, ndërsa për fushat tjera kanë dhënë mendim se rreziku për korrupsion është më i ultë, ku edhe pse aktualisht është me rrezik të ulët duhet të ushtrohet kontroll i vazhdueshme.


## 10. MATRICA E VLERËSIMIT TË INTENSITETIT TË RREZIKUT


<b>Pasoja /Ndikimi</b>	<b>Madhor</b>	10																				
		9																				
		8																				
	<b>Mesatar</b>	7																				
		6																				
		5																				
		4																				
	<b>Vogël</b>	3																				
		2																				
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10											
<b>Intensiteti rrezikut (gjasat X ndikimi)</b>	<b>i</b>	<b>Ulët</b>			<b>Mesatar</b>				<b>Lartë</b>													
		<b>Probabiliteti/Gjasat</b>																				


Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Duke pasur parasysh situatën aktuale, në MZHR, probabiliteti që rastet e korrupsionit dhe/apo cenimit të integritetit të ndodhin janë të ulëta mirëpo në rast se do të ndodhnin do të kishin pasoja të mëdha për integritetin e vetë MZHR-së.

## **11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITET**

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga zyrtari përgjegjës në MZHR, si dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Koordinatori/kryesuesi i grupit punues prezanton Planin e Integritetit Sekretarit të Përgjithshëm të MZHR-së për miratim. Pas shqyrtimit dhe adresimit të vërejtjeve eventuale, Sekretari i Përgjithshëm i MZHR-së nënshkruan miratimin e Planit.

Vendimi për miratim dhe plani i integritetit do t'i dorëzohet Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e miratimit.

Zbatimi i planit të integritetit do të monitorohet në vazhdimësi edhe nga zyrtari përgjegjës i MZHR-së për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë duke u zbatuar dhe janë efektive në avancimin e performancës së integritetit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut kanë prodhuar efektet e planifikuara.



## FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	Mos koordinimi dhe informimi i Burimeve Njerëzore për trajnimet dhe punëtorit në të cilat marrin pjesë zyrtarët. Vizitat studimore të stafit jashtë vendit të organizuara nga MZHR dhe ose donatorët nuk koordinohen mjaftueshëm me njësitë përkatëse për pjesëmarrje në to të stafit përkatës	Legjislati i fuqi  Raporti mbi trajnimet e zyrtarëve	4	3	12	Planifikimi në fillim të vitit trajnimeve, vizitave studimore jashtë vendit, regjistrimi i tyre në sistemin përkatës për menaxhimin e burimeve njerëzore.	Departamentet me Divizionet e MZHR-së	Në vazhdimësi

	Kryerja e detyrave shtesë që nuk janë në përshkrimin e vendit të punës rrit rrezikun e mungesës së llogaridhënies dhe nëse këta zyrtar kryejnë detyra që nuk kanë aftësi dhe shkathësi të nevojshme mund të shkaktojnë dëme	Përshkrimet e punës dhe formularët e vlerësimit të punës nuk reflektojnë plotësisht me detyrat shtesë	5	6	30	Rritja e stafit të MZHR-së	Divizioni i Burimeve Njerëzore	Janar-Dhjetor të çdo viti
	Mungesa e njohurive të zyrtarëve për integritetin dhe kundër korrupsionin	Legjislacioni në fuqi	3	6	18	Trajnime për integritetin dhe Kundër Korrupsionin	Divizioni i Burimeve Njerëzore	TM4
	Mos deklarimi i mundshëm i dhuratave	Ekziston obligimi ligjor për deklarim të dhuratave	8	3	24	Informimi i zyrtarëve të pasojat e mos deklarimit të dhuratave	Divizioni i Burimeve Njerëzore	TM1
2.	Menaxhimi i financave mundshme nga planifikimi në realizim të buxhetit	Legjislacioni në fuqi	4	6	24	Planifikimi i buxhetit adekuat në proporcion me shpenzimet	DB dhe njësitë brenda MZHR-së	TM1

3.	Shërbime të sigurisë së përgjithshme dhe të pamjaftueshme të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet dhe aktet nënligjore	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të sistemeve	DSHP /DTIL	12 muaj
		Inventarizimi dhe regjistrimi i aseteve	5	6	30	Përditësimi i regjistrimit të brendshëm i aseteve	DSHP /DTIL	12 muaj
		Mungesa e një hapësire adekuate për arkiv	8	8	64	Pasurimi me rrafte dhe krijimi i kushteve për arkiv	DFSHP/DADA	12 muaj
	Dërgimi i materialeve arkivore në arkivin shtetëror pas afatit të ruajtjes		3	3	9			



## FUSHAT E VECANTA TË RREZIKUT

Identifikimi i rrezikut		Intensitetit rrezikut				Masat ndaj rrezikut			Afati i realizimit
Nr	Fusha rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	
1.	Planifikim Kordinim për Zhvillim Rajonal	Mungesa e stafit për krijimin e komisioneve për monitorim	Legjislacioni në fuqi	7	9	63	Rritja e numrit të stafit profesional	ZKA/DPKZHR	Janar-Dhjetor të çdo viti
		Vonesa në zbatimin e projekteve kapitale te financuar nga MZHR në komunat përfituese	Legjislacioni në fuqi	5	6	30	Monitorimi i vazhdueshëm i projekteve në teren	DPKZHR	Janar-Dhjetor të çdo viti
		Vonesa në zbatimin të projekteve të financuar nga MZHR ne bizneset përfituese	Legjislacioni fuqi	8	9	72	Monitorimi i vazhdueshëm në teren i bizneseve përfituese	DPKZHR	Janar-Dhjetor të çdo viti

2. Prokurimi Publik	Rritja e profesionalizimit në pranimin e mallrave dhe menaxhimin e kontratave	Ligji për prokurimin publik Rregullat e KRPP	3	10	30	Trajnimi i vazhdueshëm për personelin përgjegjës në fushën e menaxhimit të kontratave dhe komisioneve të pranimit	Prokurim/ DBNJ	12 muaj
	Mangësi në procesin e hartimit të planit të prokurimit dhe zbatimit të tij	Ligjet dhe aktet nënligjore	7	8	56	Vlerësimi me kujdes i nevojave të departamenteve dhe njësisve të veçanta të MZHR-së dhe përfshirja e tyre në Plan të Prokurimit si dhe pjesëmarrja e njësisve kërkuese në takimet rreth planifikimit të prokurimit	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Divizioni i Prokurimit, Njësitë kërkuese	TM3 dhe TM4
	Mangësi në hartimin e specifikave teknike, para masave dhe paralogaritë të aktiviteteve të prokurimit	Ligjet dhe aktet nënligjore	6	9	54	Ngritja e kapaciteteve profesionale (stafi) për përgatitjen e specifikimeve teknike profesionale për aktivitetet e prokurimit në harmoni me LPP dhe aktet e tjera ligjore	Njësitë kërkuese	12 muaj

3.	Auditimi i Brendshëm	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga raportet Njësia e auditorit të Brendshëm(NJAB)	Ligjet dhe aktet nënligjore	2	8	16	Raportimi periodik nga ana e drejtorëve të departamenteve dhe udhëheqësit e njësive të veçanta të audituara për zbatimin e rekomandimeve të NJAB . Verifikimin në baza tre mujore rreth zbatimit të rekomandimeve të NJAB, dhe njoftimi i USPP dhe Komitetit të Auditimit.	Entitetet e audituara	Në vazhdimësi
	Mos përgatitja e të gjitha planeve të veprimit për implementimin e rekomandimeve nga Departamentet dhe Njësit e veçanta të audituara nga NJAB	Ligjet dhe aktet nënligjore	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	9	27	Me përfundimin e raportit final	Entitetet e audituara	Me finalizimin e raportit të NJAB
	Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore brenda Njësisë së Auditimit	Ligjet dhe aktet nënligjore	Ligjet dhe aktet nënligjore	6	9	54	Rekrutimi i stafit të mjaftueshëm për funksionimin adekuat të Njësisë së Auditimit	Divizioni i Burimeve Njerëzore	Janar-Dhjetor